



RAPORTI VJETOR

I PUNËS SË

AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

VITI 2021

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti paraqet punën e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për vitin 2021, sipas objektivave të përcaktuara në planin e punës së institucionit si dhe situatwn aktuale lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Një pjesë e madhe e punës së ASHDMF lidhet me monitorimin e punës së NJMF/PMF për marrjen në mbrojtje të fëmijëve dhe për këtë arsye në raport janë pasqyruar gjërësisht të dhëna shifrore mbi rastet e menaxhuara nga NJMF/PMF të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës, etnisë ndërhyrjet dhe shërbimet e ofruara për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, problematikat, natyrën e rrezikut dhe llojet e abuzimit. Në raport paraqitet situata për kategori të ndryshme të fëmijëve në rrezik duke përfshirë edhe fëmijët që janë identifikuar jashtë sistemit arsimor, fëmijët e pashoqëruar shqiptarë dhe të huaj, fëmijët në konflikt me ligjin etj.

Këtë vit është mundësuar [Platforma Digjitale Online](#) që ka për qëllim vizualizimin dhe shfaqjen e të dhënave vjetore nga institucionet në nivel qendror, ministritë e linjës, bashkitë dhe INSTAT, lidhur me indikatorët e të drejtave të fëmijëve. Platforma ofron informacion statistikor mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna abuzimi, shfrytëzimi për periudhën kohore 2017-2021.

Në raport gjenden të dhëna mbi hartimin e dokumentave të rinj ligjor të miratuar së fundmi, problematikën e shkeljeve etike dhe të të drejtave të fëmijës gjatë raportimit të rasteve të fëmijëve në media, aktivitetet e organizuara nga ASHDMF me qëllim rritjen e sensibilizimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Gjatë 2021 janë organizuar një numër i madh trajnimesh për PMF dhe profesionistët në nivel vendor, të cilat janë ofruar nga ASHDMF apo ofrimi i tyre është koordinuar nga ASHDMF në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm

Tabela e mëposhtme jep një informacion të përmbledhur të të dhënave kryesore të raportit për vitin 2021

Numri i rasteve të menaxhuara në total nga PMF	2389
Numri i rasteve të reja	1047
<i>Rastet e reja sipas grupmoshës</i>	
<i>0-3 vjeç</i>	110
<i>4-6 vjeç</i>	151
<i>7-9 vjeç</i>	157

<i>10-12 vjeç</i>	142
<i>13-15 vjeç</i>	257
<i>16-18 vjeç</i>	230
<i>Rastet e reja sipas gjinisë</i>	
<i>Femra</i>	521
<i>Meshkuj</i>	526
<i>Rastet e reja sipas etnisë</i>	
<i>Rom</i>	100
<i>Egjiptian</i>	118
<i>Popullsi maxhoritare (Shqiptare)</i>	811
<i>Fëmijë me shtetësi të huaj</i>	18
Numri i rasteve të reja te fëmijëve të identifikuar/referuar sipas aktorëve	
<i>NJMF</i>	203
<i>Policia</i>	261
<i>OJF</i>	90
<i>Prindi</i>	78
<i>Fëmija</i>	12
<i>Institucione arsimore</i>	167
<i>Institucione shëndetësore</i>	19
<i>Administratori i NE</i>	17
<i>Të tjerë</i>	200
Numri rasteve të mbyllura	470
<i>Rastet e mbyllyra sipas arsyes</i>	
<i>fëmija është mbi 18 vjeç</i>	73
<i>është reduktuar niveli i rrezikut, në rrezik të ulët/mungesë rreziku</i>	269
<i>fëmija jashtë rrezikut dhe nuk ka më gjasa të kthehet përpara se të mbushë 18 vjeç</i>	22
<i>fëmija vdes</i>	0

<i>fëmija është transferuar në një vendbanim tjetër</i>	106
Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut	2389
<i>i ulët</i>	860
<i>i mesëm</i>	1148
<i>i lartë</i>	276
<i>emergjent</i>	105
Numri i vizitave të kryera në familje	2762
Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave	2389
<i>dhunë fizike</i>	155
<i>dhunë seksuale</i>	73
<i>dhunë psikologjike</i>	249
<i>trafikim</i>	38
<i>fëmijë në situatë rruge</i>	228
<i>neglizhim</i>	315
<i>probleme social-ekonomike</i>	797
<i>aftësi e kufizuar</i>	56
<i>mosregjistrim në gjendjen civile</i>	27
<i>fëmijë në konflikt me ligjin</i>	212
<i>Tjetër (Psh: Bullizëm, sjellje delinkuente, abuzim online, martesë e hershme, gjakmarrje etj.)</i>	239
Numri i fëmijëve për të cilët është marrë masë mbrojtjeje sipas llojit të masës	
<i>Masa emergjente për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative (total)</i>	52
<ul style="list-style-type: none"> • Miratuar nga drejtori i shërbimeve shoqërore në bashki 	52
<ul style="list-style-type: none"> • Konfirmuar nga gjykata 	36
<i>Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative (total)</i>	25
<ul style="list-style-type: none"> • Miratuar nga drejtori drejtori shërbimeve shoqërore në bashki 	25

• Konfirmuar nga gjykata	21
<i>Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar</i> (Kjo masë miratohet vetëm nga drejtori shërbimeve shoqërore në bashki, nuk ka nevojë për konfirmim nga gjykata)	99
Numri i fëmijëve që janë identifikuar për tu regjistruar në shkollë,	289
fëmijë për regjistrim në klasë të parë	52
fëmijë në situatë rruge	31
fëmijë të paregjistruar në gjendje civile;	6
fëmijë me aftësi të kufizuar, të cilët mbështeten nga NJMF	47
fëmijët mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;	37
fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën	71
fëmijë që kanë braktisur shkollën	45
Fëmijët e pashoqëruar	
Numri i kërkesave të shqyrtuara nga ASHDMF për riatdhesim të fëmijëve shqiptarë nga vendet e BE	42
Numri i fëmijëve të riatdhesuar	9
Numri i fëmijëve të huaj të pashoqëruar	7
Raste të referuara nga ASHDMF	
Raste të referuara dhe asistence teknike nga ASHDMF për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve	96
Ankesa zyrtare tek AMA	17
Raportime për faqe me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme	450

1. Bashkëpunim për përmirësimin e politikave dhe ndërhyrjeve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së ndërhyrjeve për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, ASHDMF në bashkëpunim me UNICEF kanë filluar punën për hartimin e **Kritereve të Cilësisë së Punës së Strukturave për Mbrojtjen e Fëmijës**. Kriteret do t'i shërbejnë ASHDMF për të vlerësuar dhe monitoruar në mënyrë më efektive punën e NJMF, PMF në të gjithë vendin. Pas përfundimit të këtyre kritereve, do të vijojë puna për hartimin e metodologjisë së punës së ASHDMF për monitorimin e strukturave. Kjo metodologji do të synojë të masë cilësië e ndërhyrjes për mbrojtjen e fëmijës duke marrë në konsideratë edhe mendimin e përfituesve të shërbimit.

ASHDMF ka marrë pjesë dhe ka kontribuar gjatë procesit të hartimit të **Agjendës së re Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës (AKDF) 2021 – 2026**, dokumenti strategjik i Qeverisë Shqiptare për realizimin e të drejtave të fëmijëve në vend. AKDF është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, si edhe në konsultim me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

AKDF-ja përmban 4 qëllime strategjike: i) Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve; ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve; iii) Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë; iv) Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Qëllimet e identifikuara mundësojnë vazhdimësinë e Agjendës së mëparshme Kombëtare dhe përfrimin me Strategjinë e re të Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijës 2022 – 2027.

Është miratuar **Udhëzimi Nr 262, datë 26.05.2021 “Për miratimin e metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës”**. Ky protokoll pune, ka si qëllim standardizimin dhe unifikimin e procedurave në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin. Dokumenti ofron udhëzime praktike, që përbëjnë kornizën e strukturuar të rolit e punonjësit të mbrojtjes së fëmijëve, në menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin. Ky dokument u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe fondacionin Terre des Hommes.

ASHDMF ka bashkëpunuar me UNICEF dhe ARSIS për hartimin e draft **Planit të Reagimit “Për mbrojtjen e fëmijëve në situatat e emergjencave”** Ky draft plan është prodhim i Grupit të Punës për Mbrojtjen e Fëmijëve në Emergjencë, i cili u krijua si një grup ad-hoc menjëherë pas tërmetit të vitit 2019, me synimin për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive emergjencave në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, nëpërmjet koordinimit të të gjitha agjencive të përfshira në programet e mbrojtjes së fëmijëve.

2. Monitorimi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. ASHDMF mbledh të dhëna në nivel kombëtar për mbrojtjen e fëmijës dhe analizon nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” institucionalizon Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) si struktura për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimit të rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

Bazuar në VKM Nr. **267, datë 12.4.2012** “Për llojet dhe mënyrën e shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore të kërkuara nga ASHMDF nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, NJMF-të, raportojnë periodikisht, çdo tre muaj dhe një herë në vit për punën e tyre në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje nga dhuna, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi.

Për vitin 2021 shifrat tregojnë për një total prej **2389 fëmijë të trajtuar nga 241 Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve** në nivel kombëtar. Rastet e menaxhuara janë kryesisht raste të fëmijëve në rrezik apo viktimë të dhunës, abuzimit, neglizhencës apo shfrytëzimit. Nga këto, janë identifikuar **1047 raste të reja**, pjesa tjetër janë raste të mbartura nga vitet e mëparshme, të cilat vazhdojnë të jenë në menaxhim nga NJMF.


Nga raportimet rezulton se 51 NJMF kanë menaxhuar të paktën një rast dhe 10 NJMF nuk kanë menaxhuar asnjë rast gjatë vitit 2021. Këto shifra tregojnë se në nivel kombëtar, NJMF duhet të rrisin aktivitetin e punës së tyre në identifikimin e rasteve të fëmijëve në rrezik për mbrojtje si dhe të rrisin bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse. Gjatë 2021 janë **mbyllur 470 raste**.

Viti 2021		
Raste total	Raste të reja	Raste të mbyllura
2389	1047	470

Numrin më të madh të rasteve të menaxhuara e raporton NJMF e bashkisë Tiranë, duke qenë se kjo bashki ka dhe numrin më të madh të njësisve administrative. Numër të madh rastesh kanë raportuar edhe bashkitë Kamëz, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë

Rastet e Reja

Përsa i përket numrit të rasteve të reja të identifikuara (1047 raste) sipas grupmoshës, vihet re se grupmosha e fëmijëve 13-15 vjeç, ka numrin më të madh të rasteve të marra në mbrojtje, 257 raste të reja për vitin 2021.



Nga 1047 raste të reja të identifikuara këtë vit, 811 raste kanë qenë fëmijë nga popullsia mazhoritare, 100 raste janë fëmijë nga etnia rome dhe 118 raste janë fëmijë nga etnia egjiptiane. Gjatë 2021, punonjësit për mbrojtjen e fëmijës kanë marrë në mbrojtje 18 raste të fëmijëve me shtetësi të huaj.

Djemtë zënë numrin më të madh të rasteve të reja të identifikuara me 526 raste, ndërsa femrat me 521 raste.



Identifikimi/Referimi i Rasteve

Numri më i madh i rasteve është raportuar nga strukturat e policisë, 261 raste si dhe vetë PMF kanë identifikuar 203 raste. Vetë fëmijët kanë referuar 12 raste dhune pranë strukturave përgjegjëse. Prindërit dhe familjarët po marrin gjithmonë e më tepër një rol aktiv në referimin dhe denoncimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve duke raportuar 78 raste.

Institucionet arsimore dhe shëndetësore kanë kontribuar në identifikimin dhe referimin e rasteve, përkatësisht 167 raste të referuara nga institucionet arsimore dhe 19 raste nga institucionet shëndetësore.

Gjithashtu, OJF që veprojnë në terren kanë referuar 90 raste dhe administratorët e ndihmës ekonomike që kanë raportuar 17 raste, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe gjatë procesit të menaxhimit të rasteve.

Mediat, qytetarët, skuadrat e terrenit për fëmijët në situatë rruge, gjykata, prokuroria etj kanë qënë bashkëpunorë duke shënuar një numër prej 200 rastesh të referuara për vitin 2021.


Vizitat në Familje

Gjatë këtij viti NJMF-të në gjithë vendin kanë realizuar **2762 vizita në familje**. Vizita kanë si qëllim kryesor identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Përmes tyre bëhet edhe vlerësimi i situatës social ekonomike të familjeve, njohja me rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballen fëmijët, komunikimi dhe ndërveprimin ndërmjet anëtarëve të familjes me fëmijët. Gjithashtu përmes vizitave bëhet rivlerësimi i rasteve të cilat janë në proces menaxhimi. Nga raportimet rezulton se PMF-të në të gjitha bashkitë kanë realizuar vizita në familje, në nënryrë periodike dhe sipas nevojës së rastit. Ku strukturat për mbrojtjen e fëmijës kanë vendosur ‘Masa mbrojtëse’ për fëmijën, vizitat në familje kanë qënë më të shpeshta dhe të qëllimshme për ndjekjen e situatës.

Rastet e Mbyllura

Për vitin 2021 janë **mbyllur 470 raste** në total. 269 raste janë mbyllur për shkak se është reduktuar niveli i rrezikut, 106 raste janë mbyllur për arsyen se fëmija është transferuar në një vendbanim tjetër. Nga të gjithë rastet e mbyllura, 22 raste janë vlerësuar pa rrezikshmëri për fëmijën dhe në 73 raste të tjera fëmija pasi ka mbushur 18 vjeç, (PMF ndjek rastet për fëmijë deri 18 vjeç) është deleguar për ndjekje në struktura të tjera.


Numri i rasteve të mbyllura Viti 2021



Niveli i Rrezikut

Vlerësimi i nivelit të rrezikut është një hap i rëndësishëm gjatë procesit të menaxhimit të rastit. Sipas nivelit të rrezikut në të cilin ndodhet fëmija, vendosen masat e mbrojtjes të përshtatshme për fëmijën ose përcaktohen veprimet që duhet të ndërmerren nga aktorët vendorë të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e fëmijës. Nga raportimet për vitin 2021 rezulton se në përgjithësi PMF trajtojnë raste me rrezikshmëri të ulët dhe të mesme, përkatësisht 860 dhe 1148 raste. Gjithashtu, PMF kanë menaxhuar 276 raste me rrezikshmëri të lartë dhe 105 raste në situatë emergjente.

Numri i rasteve të menaxhuara sipas nivelit të rrezikut Viti 2021



Problematikat e Rasteve të Trajtuar

Problematikat e rasteve të fëmijëve në nevojë, që trajtohen nga PMF-të janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Rastet e fëmijëve që u përkasin familjeve me **probleme social ekonomike** janë më të raportuarat dhe si rrjedhim janë më shumë të trajtuara. Theksojmë se “Varfëria” apo “Problemet ekonomike në familje” në vetvete, nuk janë kriteret e mjaftueshme që NJMF-të të hapin procesin e menaxhimit të rasteve. Por nëse fëmijët që jetojnë në kushte të tilla, përjetojnë mohim apo mungesë aksesit në shërbime e të drejta, atëherë ata merren në mbrojtje nga NJMF. Për vitin 2021 janë menaxhuar **797 raste** të tilla.

Fëmijët në situatë rruge mbetet përsëri një problematikë e raportuara nga NJMF-të. Një numër i madh i fëmijëve në situatë rruge janë identifikuar nga skuadrat e terrenit. Për periudhën raportuese janë trajtuar **228 raste**. Raste më të shumta janë në Tiranë, Shkodër Elbasan. Numri më i madh i rasteve janë identifikuar nga skuadrat e terrenit në bashkitë ku zbatohet plani i veprimit për fëmijë në situatë rruge. Ngritja dhe funksionimi i skuadrave të terrenit është realizuar në zbatim të planeve lokale për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

Dhuna ndaj fëmijëve mbetet fenomen shqetësues. Për vitin 2021, janë marrë në mbrojtje **792 fëmijë** të cilët kanë përjetuar një nga format e dhunës.

Janë trajtuar **155 raste të dhunës fizike**. Shpesh rastet e dhunës fizike janë raportuar si rezultat i dhunës në familje. Konfliktet mes prindërve, fëmijëve ose të afërmëve në familje degjenerojnë në dhunë fizike e fëmijët bëhen pjesë e saj.

Gjatë periudhës raportuese PMF kanë trajtuar rreth **249 raste të dhunës psikologjike**. Në vitet e fundit janë rritur ndjeshëm rastet e dhunës psikologjike për shkak të përdorimit të pakontrolluar të internetit nga fëmijët si dhe keqpërdorimit të fotove apo videove të tyre personale. Fëmijët, kryesisht vajzat, shantazhohen e kercënohen lidhur me përdorimin apo shpërndarjen e fotove/videove intime. Në disa raste të tjera foto/video të fëmijëve janë përdorur për bullizmin e tyre online nga bashkëmoshatarë apo persona të tjerë, duke shkaktuar dhunë psikologjike e ankth. Rritja e numrit të divorceve ka sjellë probleme të medha edhe tek fëmijët. Ata shpesh përdoren nga prindërit si mënyrë hakmarrje ndaj njëri-tjetrit, duke e vendosur fëmijën në qender të konfliktit. Janë raportuar gjithashtu problematika midis prindërve dhe fëmijëve, që vijnë si rrjedhojë e konflikteve familjare që lidhen me zhvillimin gjatë periudhës së adoleshencës.

Rastet e **dhunës seksuale** me fëmijët, konsiderohen rastet më të rënda të dhunës ndaj fëmijëve. Në këtë vit janë trajtuar **73 raste**. Abuzimet me fëmijë kryhen zakonisht nga persona të njohur për fëmijën dhe familjen. Fëmijët nga familje të varfëra, me prindër me PAK apo me sëmundje të shëndetit mendor janë më të rrezikuar për të qënë viktimat e abuzimeve seksuale.

Abuzimet janë raportuar dhe në rastet e vajzave adoleshente, të cilat mashtrohen nga persona më të rritur, që pretendojnë për marrëdhënie sentimentale e më pas abuzojnë seksualisht me to.

Janë trajtuar **315 raste te neglizhimit** të fëmijëve. Shumica e rasteve kanë ndodhur në familje me probleme të theksuara ekonomike, apo në familje ku prindërit kanë braktisur familjen ose vuajnë nga probleme të shëndetit mendor e janë të paafte të kujdesen për fëmijët e tyre. Rastet lidhen gjithashtu dhe me neglizhencën e prindërve për të ushtruar të drejtën për arsim të fëmijëve.

Fëmijët të cilët janë marrë në mbrojtje për mungesë të aksesit në të drejta e shërbime për shkak të **aftësisë së kufizuar** zënë një shifër prej **56 rastesh**. Menaxhimi I këtyre rasteve bëhet më i vështirë e më kompleks, kur situata ndërthuret me problematika të tjera të abuzimit fizik ose seksual tek fëmijët.

Për vitin 2021 kanë trajtuar **38 raste të fëmijëve viktime/viktima të mundshme trafikimi** ku në bashkëpunim me aktorët e tjerë kanë siguruar shërbimet, ndërhyrjet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve.

Fëmijët në konflikt me ligjin, janë një grup i ri fëmijësh në nevojë për mbrojtje që po trajtohet në bazë të ligjit nga PMF-të. Në total janë **212 raste** të trajtuara. PMF raportojnë se shpesh në këto raste kanë bashkëpunuar me Shërbimin e Provës për implementimin e planeve rehabilituese për fëmijët autorë të veprave penale. Për fëmijët në konflikt me ligjin nën apo në moshë të përgjegjësisë penale, PMF-të kanë ndërhyrë duke hartuar dhe zbatuar Planet Individuale të Mbrojtjes së këtyre fëmijëve, referimin në institucione arsimore, monitorimin ditor të fëmijës, vizita në familje, referim te zyrat e punësimit apo kurse profesionale etj.

Në zbatim të legjislacionit për gjendjen civile, NJMF-të janë angazhuar në procesin e regjistrimit të fëmijëve në zyrat e gjendjes civile. Në bashkëpunim me këto zyra si dhe me organizatat partnere, po punohet për regjistrimin e çdo fëmije të peregjistruar. NJMF-të ndihmojnë prindërit për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e fëmijës dhe bashkëpunojnë me NJMF-të e bashkive të tjera në rast nevojë për transferimin e dokumentave nga një bashki në tjetrën. Për vitin 2021 rezultojnë **27 raste të regjistruar në gjendjen civile**.

Problematika të tjera si: bullizmi online, sjellje devijante, riatdhesimi nga vendet e BE, fëmijë të huaj të pashoqëruar, janë trajtuar gjithashtu nga NJMF. Ndonëse secila problematikë është paraqitur në shifra të vogla, në total këto janë 239 raste.

Masat e Mbrojtjes

Në ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” përcaktohen masat e mbrojtjes që mund të aplikojnë NJMF, kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurtë për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për vitin 2021 NJMF kanë marrë në **total 176 Masa Mbrojtje**.

Janë marrë 52 Masa Emergjente të Mbrojtjes, për largimin e menjëhershëm të fëmijës nga familja. Këto masa sigurojnë largimin e fëmijës nga një situatë rreziku, qoftë nga familja apo prindërit, në mënyrë të menjëhershme.

Gjithashtu janë marrë 25 Masa të Mbrojtjes për Vendosjen e Fëmijës në Përkujdesje Alternative. Për vitin 2021 janë aplikuar 99 Masa të Mbrojtjes për Mbikëqyrjen e Specializuar të Fëmijës në Mjedisin Familjar. Mbikëqyrja e specializuar në mjedisin familjar vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, i cili ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit të saj ASHDMF, shqyrton raportimet nga institucionet dhe ankesat e qytetarëve që referohen në Agjenci, nëpërmjet rrugës zyrtare shkresore apo e-mailit zyrtar të institucionit, si dhe monitoron çdo ditë median e shkruar dhe vizive online lidhur me identifikimin e rasteve dhe çështjeve për fëmijët e abuzuar, neglizhuar, shfrytëzuar, dhunuar etj. Gjatë 2021, ASHDMF ka identifikuar dhe ka referuar për ndjekje pranë NJMF-ve përkatëse, **96 raste** në total të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Këto kanë qenë kryesisht raste fëmijësh të dhunuar, abuzuar, shfrytëzuar, për të cilët është ndërhyrë menjëherë. Menaxhimi i këtyre rasteve bëhet nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës përgjegjëse, nën monitorimin dhe supervizimin e ASHDMF.

Ndonëse detyra e ASHDMF është monitorimi dhe dhënia e ndihmës teknike për menaxhimin e rastit, në disa raste, kryesisht raste të abuzimit seksual, për shkak të natyrës së rëndë të abuzimit dhe vështirësisë së paraqitur, ASHDMF ka koordinuar institucionet qendrore e vendore si dhe ka zbritur në terren për të koordinuar aktorët lokalë dhe për të ndihmuar konkretisht në hartimin e planit të mbrojtjes për fëmijën dhe menaxhimin e rastit

3. Mbrojtja e fëmijëve shqiptarë të riatdhesuar dhe fëmijët e huaj të pashoqëruar

Ligji 18/2017 “*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*” dhe VKM Nr.111, datë 06.03.2019 “*Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimit të fëmijës*”, kanë për qëllim të garantojnë të drejtat e fëmijëve të pashoqëruar, shqiptarë apo të huaj, dhe t’i ofrojnë atyre mbrojtjen më të lartë të mundshme, gjatë procesit të riatdhesimit apo kthimit në familje.

Sipas dispozitave në VKM Nr. 111 datë 06.03.2019, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet bashkërendimit të punës midis autoriteteve përgjegjëse shqiptare dhe të huaja, të përfshira në procesin e mbrojtjes së fëmijës.

Fëmijët shqiptarë të pashoqëruar

Nga momenti i miratimit të VKM (mars 2019) dhe deri në dhjetor 2019 janë paraqitur 111 kërkesa për ripranimin e fëmijëve shqiptarë të pashoqëruar në vendet e BE dhe janë riatdhesuar 34 fëmijë shqiptarë.

Për vitin 2020 janë paraqitur 64 kërkesa për riatdhesim dhe janë riatdhesuar 9 fëmijë shqiptarë. Gjatë 2021 janë paraqitur 42 kërkesa për riatdhesim dhe janë riatdhesuar 9 fëmijë shqiptarë.

Gjermania është vendi me numrin më të madh të kërkesave për riatdhesimin e fëmijëve shqiptarë. Vendet e tjera kanë paraqitur kërkesa për riatdhesim janë gjithashtu edhe Suedia, Islanda, Holanda, Anglia, Italia. Fëmijet e riatdhesuar janë përgjithësisht të seksit mashkull dhe mosha e tyre varion mesatarisht nga 16 vjec e lart. Këta fëmijë nuk kanë më të drejtë të qëndrojnë në territorin e shteteve anëtare të BE e për këtë arsye janë subjekt i procedurës së kthimit vullnetar apo kthimit të detyruar me vendim gjykatë.

Në përgjithësi familjet shqiptare shprehen të gatshme për të pranuar riatdhesimin e fëmijëve të tyre, ndonëse ka pasur edhe raste kur prindërit kanë refuzuar të presin fëmijën dhe të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. Në këto rrethana, fëmijët janë trajtuar si fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe janë aplikuar procedurat e parashikuara në legjislacion. Fillimish fëmijët janë pritur nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës e më pas janë akomoduar në qendrat e emergjencës dhe kanë përfituar shërbimet që ofrojnë qendrat, deri në sistemimin afatgjatë të tyre. Shërbimi në qendrat e emergjencës ofrohet për një periudhë 21 ditore e më pas fëmijët duhet të sistemohen diku tjetër.

Sistemimi afatgjatë për fëmijët e riatdhesuar shqiptarë, të cilët nuk priten nga familjet e tyre, përbën problem.

Për të siguruar mbrojtjen më të mirë për këta fëmijë, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si autoriteti përgjegjës ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri me qëllim ofrimin e shërbimeve të përkohshme të përkujdesit në një qendër pritëse, si dhe ofrimin e paketave riintegruese sipas nevojave, me qëllim fuqizimin e familjeve deri në marrjen e vendimit përfundimtar për fëmijën.

Qendra është ngritur me fondet e Rrjetit European për Rikthimin dhe Riintegrimin (ERRIN) dhe është inauguruar në nëntor 2021. Projekti “*Mbështetje për rikthimin e fëmijëve të pashoqëruar në Shqipëri, nëpërmjet krijimit të një zgjidhjeje të sigurtë strukturore*” ka 4 partnerë kryesorë: Shërbimi i Riatdhesimit dhe Nisjes (R&DS) Hollandë, Rrjeti Evropian i Kthimit dhe Riintegrimin (ERRIN), Agjencia Shtetërore për të Drejtat e Mbrojtjen e Fëmijëve dhe SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.

Fëmijët e huaj të pashoqëruar

Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës kanë marrë në mbrojtje fëmijët e huaj të pashoqëruar të identifikuar brenda territorit të vendit:

Për vitin 2019, 21 raste të fëmijëve të huaj të pashoqëruar;

Për vitin 2020, 39 raste të fëmijëve të huaj të pashoqëruar;

Per vitin 2021, 7 raste te femijeve te huaj te pashoqeruar.

Fëmijët kanë qënë nga Siria, Pakistani, Afganistani. Shpesh këta fëmijë, në momentin e identifikimit nga policia, nuk paraqesin dokumenta identifikimi por kanë deklaruar se janë fëmijë dhe bazuar në legjislacion, janë trajtuar si të tillë.

Në mungesë të një qendre të specializuar për fëmijët e huaj të pashoqëruar, këta fëmijë janë vendosur pranë Qendrës Kombëtare Pritëse në Tiranë “Shtëpia e Ngjyrave”, që ka ofruar shërbimin për këtë kategori fëmijësh edhe pas kalimit të afatit 21 ditor të qëndrimit në qendër.

Sfidë dhe vështirësi në menaxhimin e këtyre rasteve vazhdon të mbetet çështja e kujdestarisë së fëmijëve të huaj të pashoqëruar, gjatë konfirmimit në gjykatë të masës së mbrojtjes, si dhe mungesa e një shërbimi të përshtatshëm për këtë kategori fëmijësh.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në kuadër të përmbushjes së përgjegjesive ligjore ofron trainime dhe asistencë teknike për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijëve shqiptarë që riatdhesohen si dhe fëmijëve të huaj të pashoqëruar.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës me mbështetjen e UNICEF ka organizuar workshopin me temë *“Për çështje të punës që lidhen me trajtimin e problematikave të hasura gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe të ndarë që identifikohen në territorin e Shqipërisë”*, me punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në pikat kufitare si Korçë, Devoll, Kukës, Shkodër, Gjirokasër, Durrës, Vlorë, Tiranë,

Qëllimi i Workshopit:

- Të identifikojë problematikat që PMF-të hasin në terren gjatë punës,
- Të mbledhë rekomandime dhe sugjerime për përmirësimin e legjislacionit dhe procedurave që ndiqen për menaxhimin e këtyre rasteve.
- Të prezantojë dhe të diskutojë me pjesëmarrësit një analizë të situatës ligjore, problematikave lidhur me procedurat e veprimit
- Të ndajë e diskutojë me PMF dokumentin e draft procedurave të veprimit të përmirësuar për fëmijët e huaj të pashoqëruar.

Workshopi u organizua në platformën Zoom në datën 16 dhe 17 dhjetor 2021 dhe morën pjesë **22 PMF**.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me organizatën Shërbimi Ligjor Falas TLAS, kanë organizuar 6 seminare trajnimi me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe profesionistë në nivel vendor. Qëllimi ishte informimi i PMF dhe aktorëve vendorë në lidhje me zhvillimet e fundit në legjislacion dhe mbrojtjen që duhet t'u ofrohet fëmijëve të pashoqëruar, pa shtetësi, shqiptarë apo të huaj.

Trajnimi është organizuar në platformën Zoom dhe gjithsej kanë marrë marrë pjesë **124 pjesëmarrës** (18 në Shkodër, 20 në Korçë dhe 22 në Elbasan; 32 në Tiranë, 14 në Durrës dhe 18 në Berat dhe Fier).

4. Mbrojtja e fëmijëve në mjedisin digjital

Me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit institucional, lidhur me sfidat e përditshme për t'i mbajtur fëmijët të sigurt në mjedisin digjital, ASHMDF ka bashkëpunuar me institucione si Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Autoritetin e Medias Audiovizive (AMA), të Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) si dhe me përfaqësues të policisë së shtetit.

Faqet web me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për fëmijët raportohen tashmë në një aplikacion të ri që është mundësuar nga AKCESK. ASHMDF është përdorues i këtij portali dhe sigurohet që cdo rast i referuar të ndiqet nga institucionet përkatëse për t'i ardhur në ndihmë cdo fëmije e për të siguruar mbrojtje në mjedisin digjital.

Për vitin 2021 janë identifikuar **450 faqe** në web me përmbajtje të dëmshme apo të papërshtatshme për fëmijë ose faqe ku fëmijët mund të jenë ngacmuar, shantazhuar apo dhunuar psikologjikisht në mjedisin digjital.

ASHMDF ka bashkëpunim me AKCESK për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, ku një kapitull i vecantë është mbrojtja dhe siguria online për fëmijët.

Në zbatim të kësaj strategjie dhe në vijim të bashkëpunimit institucional janë zhvilluar disa trajnime në nivel vendor për çështjet e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital (shih pjesën për trainimet në raport)

5. Monitorimi i zbatimit të të drejtave të fëmijëve

5.1 Monitorimi i zbatimit të të drejtës për arsim për fëmijët në nevojë për mbrojtje

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si në çdo fillim viti të ri shkollor ka monitoruar realizimin e të drejtës për arsim të fëmijëve për vitin akademik 2020-2021 duke pasur në vëmendje të veçantë fëmijët në nevojë për mbrojtje: si fëmijët në situatë rruge, fëmijët e familjeve me probleme sociale ekonomike dhe fëmijët me aftësi të kufizuara etj.

Mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit të tre Ministrive MASR, MB dhe MSHMS “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” si

dhe në detyrimet të përcaktuara në Ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, NJMF-të kanë bërë identifikimet në terren dhe kanë bashkëpunuar me shkollat dhe Zyrat Vendore Arsimore për evidentimin e rasteve të fëmijëve që kanë mbushur moshën e detyrimit shkollor .

Në total janë identifikuar **289 fëmijë** për tu regjistruar në shkollë, për vitin akademik 2020-2021 sipas kategorive;

- **45** fëmijë që kanë braktisur shkollën;
- **71** fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën (21 nga këta janë të rikthyer nga emigrimi);
- **37** fëmijët mbi moshën 9 vjeç që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë;
- **47** fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët mbështeten nga NJMF;
- **6** fëmijë të paregjistruar në gjendje civile;
- **31** fëmijë në situatë rruge
- **52** fëmijë për regjistrim në klasë të parë

Agjencia ka bashkëpunuar me MAS për lehtësimin e regjistrimit të fëmijëve në shkollë për raste të vështira e specifike.

Gjithashtu ASHDMF ka qenë pjesëmarrës në të gjitha takimet të grupit qendror ndërmëtor të punës së fëmijëve jashtë shkolle të organizuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve.

5.2 Monitorimi i respektimit të të drejtave të fëmijëve në raportimet e medias

ASHDMF monitoron në mënyrë të përditshme mediat me qëllim evidentimin dhe referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të fëmijëve në raportimet e mediave të shkruara dhe audiovizive. Rastet e shkeljes së të drejtave referohen pranë autoriteteve përgjegjëse me synim përmirësimin e situatës mediatike të raportimet të rasteve të fëmijëve. ASHDMF ka raportuar pranë AMA-s **17 raste** ku mediat kanë shkelur të drejtat e fëmijëve gjatë raportimeve të lajmit apo gjatë emisioneve të tjera

5.3 Mbledhja e të dhënave statistikore në nivel kombëtar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve

Bazuar në ligjin 18/2017 “ Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe VKM . Nr. 636, datë 26.10.2018 “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore”, ASHDMF ka përgjegjësinë të realizojë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për çështjet që lidhen me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve në bashkëpunim me institucionet vendore, qendrore dhe INSTAT. Agjencia mbledh të dhëna statistikore vjetore

nga ministritë e linjës, institucionet qendrore, bashkitë dhe INSTAT bazuar në listën e treguesve bashkëlidhur këtij vendimi.

Treguesit janë të ndarë në 6 fusha: mbrojtja sociale, arsimi dhe zhvillimi i hershëm, mbrojtja e fëmijëve nga dhuna/abuzimi fizik, shëndetësia, aksesit në drejtësi dhe drejtësia për të mitur.

Me miratimin e VKM-së Agjencia ka bashkëpunuar me ekspertë të UNICEF për ndërtimin e [platformes digjitale online](#) për paraqitjen e të dhënave të mbledhura nga institucionet përkatëse, lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Platforma ka për qëllim vizualizimin dhe shfaqjen e të dhënave vjetore nga institucionet në nivel qendror, ministritë e linjës, bashkitë dhe INSTAT. Ofron informacion statistikor mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna abuzimi, shfrytëzimi. Nga ana vizuale sistemi i pasqyron të dhënat në mënyrë grafike si dhe paraqet trendet në vite për çdo tregues për periudhën kohore 2017-2021.

6. Trajnimet e organizuara dhe/ose koordinuara nga ASHDMF

Në nenin 41 të Ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, është përcaktuar që ASHDMF koordinon dhe organizon trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje.

Në zbatim të këtij neni Agjencia ka organizuar trajnime me tematika që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, në bashkëpunim me organizata dhe partnerë që ofrojnë trajnime në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

- ASHDMF në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Sociale ne Universitetin e Tiranës, në shkurt 2021, në kuadër të projektit “*Rritja e kapaciteteve të punonjësve socialë që punojnë në fushën e shërbimeve sociale*” organizoi trainimin e **85 Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijës**. Këto trainime u ofruan sipas nivelit profesional të PMF-ve. Për 40 PMF të reja në detyrë, u ofrua trainimi me temë “*Vlerësimi i nevojave*”. Për 45 PMF te cilat kanë punuar prej një kohe të gjatë, u ofrua trainimi me temë “*Konsumimi profesional*”.
- ASHDMF në bashkëpunim me fondacionin Terre des hommes organizoi trajnim online 2-ditor të profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve dhe ofruesit e shërbimeve sociale në nivel vendor ne bashkitë Bashkitë Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Fier, Korçë. Trajnimi u organizua ne kuadër të Projektit “*Mbështetje emergjence dhe rimëkëmbje për fëmijët dhe familjet e prekura nga situata pandemike e COVID-19 në Shqipëri*”. Morën pjesë rreth **90 profesionistë**, punonjës te mbrojtjes së fëmijëve, punonjës te shërbimeve sociale, përfaqësues të Grupeve Teknike Ndërsektoriale (GTN), punonjësit e Qendrave Komunitare dhe profesionistë të tjerë të fushës.

- Në kuadër të menaxhimit të rasteve të fëmijëve që vijnë nga zonat e konfliktit ne Siri, ASHDMF në bashkëpunim me Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terre des Hommes siguroi zhvillimin e një cikli trajnimesh mbi *“Menaxhimin e rasteve gjatë procesit të riintegrit në komunitet të fëmijëve të përfshirë në veprime/situata të ekstremizmit të dhunshëm dhe të kthyer nga zonat e konfliktit”* në bashkitë Tiranë, Durrës, Dibër, Korçë dhe Elbasan. Trainimi targetonte profesionistët e Grupit Teknik Ndërsektorial, Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe përfaqësues të Shërbimit Social Shtetëror rajonal. Morën pjesë rreth **120 persona**
- ASHDMF në periudhën janar - qershor 2021, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Sigurisë Kibernetike ka zhvilluar trajnime me pjesëmarrjen e **37 PMF** te bashkive nga qarqet Berat, Dibër, Elbasan Vlorë, Korçë, Fier, lidhur me çështjet e sigurisë kibernetike. Në trainim bashkë me PMF morën pjesë dhe punonjës të policisë në drejtoritë vendore të policisë së qarqeve përkatëse si dhe punonjës së sigurisë nëpër shkolla.
- Në mars të 2021 ASHDMF në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri ka organizuar një takim informues nëpërmjet platformës online për prezantimin e dokumentit *“Udhëzues i analizës dhe përcaktimit të veprimeve për fëmijët që rrezikohen nga shfrytëzimi apo trafikimi”* lidhur me raportimin dhe regjistrimin e të dhënave nga PMF në bashkitë Shkodër, Elbasan, Vlorë dhe Bulqizë. Në takim morën pjesë **20 pjesmarrës**. Udhëzuesi sqaron mënyrën e mbledhjes dhe vlerësimin e të dhënave në lidhje me shfrytëzimin dhe trafikimin e fëmijëve.
- Gjatë prill - maj 2021 ASHDMF në bashkëpunim me OSBE ka organizuar takime në bashkitë Shkodër, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Bulqizë me Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve me qëllim përmirësimin e punës për mbledhjen e të dhënave për fëmijët e shfrytëzuar dhe të trafikuar, metodologjinë e mbledhjes se të dhënave në terren.
- ASHDMF në bashkëpunim me Terre des homme ka organizuar trainimin për njohjen ne Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë lidhur me *“Procedurat për menaxhimin e rasteve te fëmijëve ne konflikt me ligjin”*. Trainimi është organizuar gjate muajit qershor 2021 ne bashkitë Tirane, Durrës, Vlore, Sarande, Konispol, Livadhja, Delvinë, Dropull i Poshtëm, Përmet, Memaliaj, Tepelene, Berat, Dimal, Kuçovë, Çorovodë, Poliçan, Elbasan, Belsh, Peqin, Cërrik, Librazhd, Gramsh, Përrenjas. Kanë marrë pjesë rreth **100 pjesmarres si** : PMF, anëtare te GTN dhe punonjës të qendrave sociale .
- Në muajt shkurt dhe mars 2021, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Terre des Hommes Hungari ka koordinuar punën për përzgjedhjen e PMF në kuadër të trajnimit lidhur me drejtësinë për të mitur. Ky trajnim u zhvillua nga trajnerë ndërkombëtarë dhe kombëtarë me përvojë dhe të kualifikuar, të zgjedhur nën

projektin i-RESTORE, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Në trainim morën pjesë profesionistë të ndryshëm si: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, ndërmjetësues, psikologë, oficerë prove, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, të cilët përfshihen në praktikat e drejtësisë restauruese me fëmijë. Bashkitë që morën pjesë ishin Tirana, Lezhë, Kamëz, Fier, Gjirokastrë, Elbasan.

- Në korrik 2021, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) organizoi takimin me tematikë **“Takimi i eksperteve mbi te drejtat e fëmijëve ne politikat dhe praktikat e kthimit”**. Takimi u zhvillua në kuadër të projektit rajonal IPA II *“Mbështetje rajonale për menaxhimin e migracionit te parregullt me fokus tek mbrojtja ne Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”*, financuar nga BE. Të pranishëm ishin Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve nga bashkitë Devoll, Maliq, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, dhe ekspertë të IOM Itali, për të ndarë eksperiencat e tyre në lidhje me menaxhimin e rasteve të fëmijëve të huaj dhe migrante. Gjithsej **40 pjesëmarrës**.
- Në muajt tetor dhe nëntor 2021 ASHDMF në bashkëpunim me Koordinatorin Antitrafik dhe OSBE ka organizuar takime vendore në *bashkitë* Shkodër, Elbasan, Vlorë, Tiranë, Korçë dhe Bulqizë me Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe aktorë vendor. Qëllimi i takimit ishte njohja në terren me problematikat në lidhje me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nxitjen e bashkëpunimit ndër-institucional dhe përditësimin e bazës të së dhënave mbi rastet e identifikuar viktime të mundshme trafikimi/viktima trafikimi. Pjesëmarrës në takim ishin punonjës për mbrojtjen e fëmijëve, specialistë mbi trafikimin në polici, ASHDMF, Koordinatori Antitrafik. Pjesëmarrës rreth **30 persona**.
- Në dhjetor 2021, ASHDMF në bashkëpunim me NJMF në bashkinë Gjirokastrë ka realizuar takim me strukturat vendore të përfshira në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Takimi u realizua në nivel drejtuesish për të diskutuar rreth problematikave të fëmijëve në këtë bashki si fëmijët e pashoqëruar, dhuna seksuale , mbrojtja e fëmijëve nga forma e ndryshme të dhunës, etj. Pjesëmarrës në takim **20 profesionistë vendorë**.
- Gjatë vitit 2021 ASHDMF ka organizuar 1 workshop dhe 1 trainim lidhur me rritjen e kapaciteteve të PMF për procedurat që duhet të ndiqen për riatdhesimin e fëmijëve shqiptarë dhe fëmijëve të huaj të pashoqëruar. Informacion me të detajuar ne pjesën e raportit *“Fëmijët shqiptarë të riatdhesuar dhe fëmijët e huaj të pashoqëruar”*

7. Aktivitete sensibilizuese dhe aktivitete në kuadër të ditëve të shënuara

Në shkurt 2021, në kuadër të **Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt**, nën koordinimin e ASHMDF në disa bashki të vendit si: Dibër, Lezhe, Fushë Krujë dhe Berat janë realizuar takime informuese dhe ndërgjegjësuere nga Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve në shkollat 9 vjeçare, për mënyrën e përdorimit të internetit të sigurt nga fëmijët. Gjate takimeve u ndanë informacione e këshilla për fëmijët me temë "*Përdorimin e internetit me siguri dhe përgjegjësi*".

Gjithashtu u këshilluan prindërit apo kujdestarët ligjorë të mos lejojnë fëmijët të kenë faqe të tyre personale në Facebook, Instagram, Snapchat, TikTok, etj si dhe u informuan mbi format e rrezikshme të komunikimit online me qëllim kërcënimin, shantazhimin, rekrutimin me qëllime përfitimi seksuale etj.

Me rastin e **1 qershorit**, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtje së Fëmijës në bashkinë Mirditë organizoi takim informues dhe ndërgjegjësuar në lidhje me raportimin e rasteve të dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve me aktorë lokalë dhe fëmijë të shkollave 9 vjeçare "Pashko Vasa" dhe Shkollës 9 vjeçare Nr. 2. Aktivitetet u organizuan në Mirditë nisur edhe nga rasti i rëndë i abuzimit seksual të një vajze i identifikuar para disa ditësh në atë komunitet. Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të institucioneve vendore si nga policia, psikologë të shkollave, Zyra Arsimore, mësues dhe nga bordi i prindërve të shkollave. U diskutua për dhunën dhe abuzimin e fëmijëve, çdo lloj dhune ndaj fëmijëve është e papranueshme por veçanërisht dhuna seksuale është e patolerushme dhe duhet të raportohet menjëherë në polici ose pranë Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës. U përcollën mesazhe dhe mbi rreziqet ndaj të cilave është çdo fëmijë i moshës 6 -17 vjeç i ekspozuar gjatë përdorimit të internetit. U theksua roli i familjes/ prindërve për të komunikuar dhe për të qenë më të afërt me fëmijët. Fëmijët gjatë diskutimeve shfaqën shumë interes në marrjen e informacionit se kë duhet të kontaktojnë për të qenë të sigurtë dhe të mbrojtur. Gjatë takimit u shpërndanë dhe materiale sensibilizuese.

Gjithashtu, për **1 Qershorin** Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës në bashkitë, Pukë, Berat, Cërrik, Selenicë, Përmet, Devoll, Patos , Mailq Lezhë, Dibër, Librazhd, Vau i Dejës, Kuçovë, Divjakë dhe Shijak në bashkëpunim me aktoret vendorë dhe organizatat partnere kanë organizuar aktivitete argëtuese dhe ndërgjegjësuere me dhe për fëmijët në lidhje me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Në kuadër të **12 qershorit 2021, Ditës Botërore Kundër Punës së Detyruar**, nën koordinimin Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, janë organizuar aktivitete në disa bashki të vendit si: Elbasan, Patos , Berat , Cërrik, Maliq dhe Kukës në bashkëpunim me aktorët lokalë, qendra ditore e komunitare, shkolla, vullnetarë dhe prindër, kundër punës dhe lypjes së fëmijëve. Nëpërmjet marshimeve me fëmijët apo me profesionistët janë përcjellë mesazhe ndërgjegjësuere për qytetaret : " Mos jep lëmoshë, bëje detyrën qytetare duke raportuar fëmijët në

situatë rrugë”, “Jo punës dhe shfrytëzimit të fëmijëve”, “Mbrotjtjet” për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe të bizneseve. Janë organizuar takime me stafet administrative të bizneseve fason me qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe adresimin e problematikës së punësimit të fëmijëve në punë që rrezikojnë shëndetin fizik e mendor të fëmijës.

Përgjatë muajit tetor, në kuadër të muajit kundër trafikimit, në bashkëpunim me 61 bashkitë e vendit janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuëse dhe informuese me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi. Në këto aktivitete morën pjesë nxënës, prindërit e fëmijëve si dhe profesionistë të tjerë si mësues, psikologë, përfaqësues të policisë, përfaqësues të bashkive, përfaqësues nga organizata për mbrojtjen e fëmijëve etj. Bashkitë të cilat kanë organizuar këto aktivitete janë: Berat, Dimal, Kuçovë, Peshkopi, Durrës, Cërrik, Belsh, Gramsh, Përrenjas, Fier, Patos, Rroskovec, Lushnjë, Divjakë, Memaliaj, Devoll, Maliq, Pogradec, Kukës, Lezhë, Rrëshen, Laç, Shkodër, Vau-Dejë, Fushë-Arrëz, Tiranë, Kamëz, Vlorë dhe Selenicë.

Më 18 Nëntor Ditën Evropiane për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, Kryetarja e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve ishte e pranishme në takim me aktorët vendorë në Bashkinë Kamëz, në kuadër të parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve, nisur edhe nga rasti i rëndë i dhunës ndaj vajzës 6 vjeçare nga babai i saj në Kamëz.

Qëllim ishte diskutimi mbi parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimet seksuale. U theksua se mbrojtja e fëmijëve është detyrë e përbashkët dhe parandalimi i dhunës është prioritet. U diskutua mbi nevojën për të informuar e ndërgjegjësuar prindërit, familjen, komunitetin, shkollën dhe institucionet për të krijuar një mjedis mbështetës dhe mbrojtës për fëmijët, që refuzon dhe raporton në kohë dhunën ndaj fëmijëve. U përcollën mesazhe për fëmijët që ata duhet të kërkojnë ndihmën të mos heshtin, të komunikojnë me prindërit, mësuesit, psikologët dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve.

Në kuadër të **Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, 20 nëntor** Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve organizoi takim me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës, në bashkinë Kukës me aktorët vendorë për të diskutuar mbi “martesat e hershme”, të drejtat e shkelura nga martesat e hershme dhe çfarë mund të bëjmë për të parandaluar këtë fenomen. Gjithashtu me pjesëmarrësit u diskutua për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimet seksuale dhe raportimi në kohë i këtyre rasteve nga profesionistët. Nga stafi i Agjencisë u vu theksi që profesionistët dhe fëmijët të nxiten për të raportuar në kohë për çdo rast të identifikuar në rrezik. ASHDMF organizoi dhe një takim informues dhe ndërgjegjësuës me fëmijë të shkollës 9 vjeçare “Rezart Spahi” bashkia Kukës.

Në kuadër të javës së të drejtave të fëmijëve ASHDMF ka organizuar takime informuese dhe ndërgjegjësuëse me fëmijë të shkollave 9 vjeçare “Shefqet Tançi” Bulqizë dhe “Shkolla e Kuqe” bashkia Tiranë, me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin mbi dhunën ndaj fëmijëve, ngacmimet,

abuzimet apo edhe formave të tjera të ndryshme të dhunës online ndaj fëmijëve. Fëmijët gjatë diskutimeve shfaqën interes në marrjen e informacionit mbi pasojat e dhunës, raportimit dhe rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar ata gjatë përdorimit të internetit dhe cilët duhet të kontaktojnë për të qënë të sigurtë dhe të mbrojtur. Mesazhet që u përcollën ishin se ata vetë fëmijët duhet të kërkojnë ndihmë, të mos heshtin, por ta raportojnë dhunën. Njohja dhe raportimi i hershëm i formave të dhunës tek fëmijët mund të parandalojë pasojat e tmerrshme të saj mbi personalitetin e fëmijëve.

8. Raportime ndërkombëtare dhe në kuadër të integritit evropian

Gjatë 2021 Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës si pjesë e grupeve ndërinstitucionale të punës të ngritura në kuadër të procesit “screening” për përafrimin e legjislacionit kombëtar me acqius të BE ka dhënë kontributin e saj lidhur me analizën e direktivave të BE që kanë të bëjnë me fëmijët si pjesë e grupit të punës të udhëhequr nga Ministria e Brendshme:

- Për përafrimin e direktivave të Bashkimit Evropian me Kodin e ri Penal, me **direktivën 2011/36/BE**, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 5 prillit 2011, *mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të saj.*
- Për përafrimin e Kodit të ri Penal me **Direktivën 2011/93/BE**, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 13 dhjetorit 2011, *mbi luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve.*

Përfaqësues të ASHDMF kanë marrë pjesë në takimet periodike të komiteteve të Këshillit të Evropës për të drejtat e fëmijës dhe ka dhënë raportimet përkatëse për:

- Komitetin e Lanzarotes, që monitoron zbatimin e Konventës së Lanzarotes për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi seksual
- Steering Committee for the Rights of the Child (CDENF). Në takimet e CDENF është hartuar dhe Strategjia e re Europiane për të Drejtat e Fëmijës 2022- 2027.

REKOMANDIME

- Mirëfunksionimi i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve varet veçanërisht nga autoritetet lokale, të cilët duhet të njohin rolin dhe përgjegjësitë e tyre për të siguruar kujdes dhe mbrojtje për fëmijët dhe të koordinojnë veprimet e tyre me aktorët e tjerë vendorë të angazhuar në çështjet e mirëqenies së fëmijëve.

- Fuqizimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në rrezik për të gjitha kategoritë e fëmijëve, nëpërmjet sigurimit të mekanizmave dhe burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për të realizuar mbrojtjen e tyre.
- Marrja e masave, për verifikimin e situatës, në të gjitha shkollat, për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e internetit të pasigurt e të pakontrolluar, ndaj fëmijëve.
- Vëmendja duhet të kthehet në mirëfunksionimin dhe rritjen e kapaciteteve dhe në fuqizimin e njësive të mbrojtjes së fëmijëve që aktualisht janë të ngritura. Trajnime të ndryshme por edhe trajnime me tema specifike do të ndihmojnë në punën e punonjësve që punojnë me fëmijët duhet të jenë në vazhdimësi.
- Përcaktimi i buxheteve në nivel vendor për të menaxhuar rastet emergjente për shkak të mungesës së shërbimeve të menjehershme për sigurimin e nevojave bazë të fëmijëve apo edhe familjeve si strehim, ushqim dhe siguri.
- Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese, promovuese dhe edukuese për komunitetin. Pushteti vendor duhet ti japi prioritet këtyre aktiviteteve duke alokuar fonde të veçanta për ti ardhur në ndihmë problematikave që mund të ketë vetë komuniteti.
- Nevoja e vazhdueshme për takime/trajnime të përbashkëta ndërmjet PMF, policisë dhe specialisteve të trafiqeve lidhur me forcimin e njohurive dhe rritjen e kapaciteteve për çështje që kanë të bëjnë me trafikimin e fëmijëve.
- Marrjen e masave për ngritjen e shërbimit të specializuar për fëmijët e dhunuar seksualisht në nivel kombëtar, që do të thotë ngritjen e qendrave të posaçme me staf profesionistësh që ofrojnë shërbime të specializuara për këta fëmijë.
- Marrjen e masave për trajnimin dhe kualifikimin e stafit në vazhdimësi, për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të viktimave fëmijë të abuzuar seksualisht në të gjithë fushat: arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, drejtësi, etj.
- Investimi në burimet e duhura për të zhvilluar në mënyrë periodike analizë buxhetore me fokus fëmijët, ngritje kapacitetesh/instrumentesh për të realizuar buxhetimin me qendër fëmijën në nivel qendror dhe vendor, dhe, mbi të gjitha, të rriten alokimet financiare në të mirë të fëmijëve.
- Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë të bashkërenduar, cilësore dhe gjithëpërfshirëse, si dhe përpjekjet për të ndërgjegjësuar fëmijët dhe të rriturit për të drejtat e fëmijëve.
- Hartimi i programeve të prindërimit pozitiv të integruara në të gjitha fushat e shërbimeve, me fokus ngritjen e kapaciteteve të prindërve.

- Bashkëpunim ndërinstytucional më i fortë në nivel vendor për të punuar me fëmijët dhe familjet e tyre për trajtimin e barrierave që çojnë në braktisjen e shkollës.
- Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të fushës, si edhe bashkëpunimi ndërmjet hallkave të sistemit të drejtësisë dhe strukturave të pushtetit vendor për të zbatuar në praktikë legjislacionin për drejtësinë për të miturit.